



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr.62, datë 13.09.2018**

**PËR**

**“FILLIMIN E PROCEDIMIT ADMINISTRATIV PËR SHQYRTIMIN E  
KËRKESËS NË LIDHJE ME PORTIMIN E NUMRAVE TË SUBJEKTIT BUFALO  
SH.P.K.”**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- |                 |          |         |
|-----------------|----------|---------|
| 1. Z. Ilir      | Zela     | Kryetar |
| 2. Z. Alban     | Karapici | Anëtar  |
| 3. Znj. Edlira  | Dvorani  | Anëtar  |
| 4. Znj. Ketrin  | Topçiu   | Anëtar  |
| 5. Znj. Klarina | Allushi  | Anëtar  |

dhe sekretare Znj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 13.09.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Fillimin e procedimit administrativ për shqyrtimin e kërkesës në lidhje me portimin e numrave të subjektit Bufalo sh.p.k.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Nenet 87 e 88, pika 1 e nenit 114 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Neni 41 e në vijim i Ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Rregullore nr. 43, datë 22.9.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” e ndryshuar, (**rregullore**),

**K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të paraqitur nga Drejtoria e të Drejtave të Përdoruesve, si më poshtë:

1. Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 8259Prot., datë 27.8.2018 (nr. 2171Prot. i AKEP, datë 27.8.2018), me objekt “Mbi shkeljen e “Rregullores nr. 43 për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” nga Telekom Albania sh.a. dhe refuzimin për të zbatuar kërkesën e AKEP për detyrimin ligjor të portimit të numrit””,
2. Ankesa e depozituar me email të datës 25.8.2018 nga Bufalo sh.p.k.
3. Korrespondenca të shkëmbyera me email ndërmjet Albtelecom – Telekom Albania - AKEP.
4. Kontrata e lidhur me pajtimtarin Bufalo sh.p.k. Nr. S. 34365 dhe sipërmarrësit Telekom Albania.
5. Njoftim i Telekom Albania nr. 6687/1 Prot., datë 31.10.2018 për ndërprerje shërbimit.
6. Njoftim i Telekom Albania nr. 318 Prot., datë 30.1.2017 për përmbushje detyrimi.
7. Projektvendimin për “Fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së në lidhje me portimin e numrave të subjektit Bufalo sh.p.k.”
8. Relacioni shoqërues mbi projektvendimin;
9. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N:

1. AKEP gjatë muajve Gusht dhe Shtator 2018 ka administruar komunikime midis palëve Albtelecom sh.a., Telekom Albania sh.a. dhe Bufalo sh.p.k., për problematikën e hasur në portimin e numrave të këtij subjekti/pajtimtari, nga Telekom Albania tek Albtelecom. Pas shqyrtimit të këtyre komunikimeve, vërehet se, Telekom Albania në rolin e operatorit dhënës ka refuzuar kërkesën për portim të numrave të këtij subjekti për tek operatori marrës, Albtelecom.
2. Albtelecom sh.a., me shkresën nr. 8259 Prot, datë 27.8.2018, me objekt “*Mbi shkeljen e “Rregullores nr. 43 për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” nga Telekom Albania sh.a. dhe refuzimin për të zbatuar kërkesën e AKEP për detyrimin ligjor të portimit të numrit”*”, ka paraqitur kërkesë për ndërhyrjen e AKEP në lidhje me zbatimin Rregullores nr. 43 datë 22.9.2016, e ndryshuar, për rastin e kërkesës për portimi të numrave të subjektit Bufalo sh.p.k. Në lidhje me këtë çështje Albtelecom sh.a. shpjegon se:
  - Me kërkesë të pajtimtarit Buffalo sh.p.k, Albtelecom në rolin e operatorit marrës ka inicuar kërkesën për portim të numrave të subjektit Bufalo sh.p.k., më datë 8.8.2018. Kërkesa u refuzua nga Telekom Albania sh.a. në rolin e operatorit dhënës, fillimisht me arsyen e mospërputhjes së NIPT-it dhe më pas për detyrime të pashlyera.
  - Albtelecom sh.a. shpjegon se, pas përpjekjeve për zgjidhjen me mirëkuptim, rasti u adresua në AKEP tek personi i kontaktit të caktuar për këtë qëllim. Edhe pse u shkëmbyen disa korrespondenca mes palëve, AKEP – Albtelecom – Telekom, ky i fundit vijoi me qëndrimin duke mos i portuar numrat, me arsyen e detyrimeve të pashlyera nga ana e Bufalo sh.p.k., dhe duke mos dhënë shpjegime apo prova mbështetëse.
  - Më datë 5.8.2018, shpjegon Albtelecom, pas ndërhyrjes së AKEP, Telekom dorëzoi dokumentet mbi të cilat mbështeste refuzimin kërkesës se portimit të numrave, ku lehtësisht evidentohet se refuzimi i portimit është i pabazuar dhe dhe në kundërshtim me Rregulloren nr. 43.
  - Me email të datës 17.8.2018, AKEP pas argumentimit iu është drejtuar palëve, dhe i kërkoi Telekom Albania sh.a., zbatimin e detyrimeve ligjore dhe marrjen e masave për vijim e procesit të portimit të numrave.
  - Në vijim, Albtelecom shpjegon se i ngriti edhe njëherë kërkesat për portim, por Telekom vijoi me refuzimin me arsyen e detyrimeve të pashlyera. Albtelecom duke patur parasysh edhe sqarimin e dhënë nga AKEP, e përsëriti edhe njëherë kërkesën

- për portimin e numrave të Bufalo sh.p.k., më datë 22.8.2018, por Telekom vijoi me të njëjtin qëndrim refuzues.
- AKEP përsëriti qëndrimin drejtuar Telekom Albania sh.a., duke lënë afat për zbatimin e detyrimeve ligjore dhe finalizimin e procesit të portimit të numrave dhe informimin në AKEP brenda datës 22.8.2018.
  - Telekom vijoi me qëndrimin refuzues në përgjigjen me email të datës 22.8.2018, ku vërehen përpjekje të pambështetura dhe të paargumentuara ligjërisht, në lidhje me refuzimin e kërkesave për portim të numrave të subjektit Bufalo sh.p.k.
  - Altelecom shpjegon se, në rast se Telekom po e trajton rastin Bufalo sipas kontratës së pajtimit, duhet të kishte terminuar me kohë të gjithë kontratën e shërbimit të këtij klienti, meqënëse ka patur detyrime të pashlyera, që pas ndërprerjes së shërbimit në tetor 2016, referuar aneksit të kontratës, që e konsideron pjesë të kontratës së tërë. Në të kundërt, Telekom zbaton në mënyrë diskriminuese dhe njëanshmërisht sipas interesave të saj kushtet e kontratës së pajtimit ndaj pajtimtarëve të tij.
  - Altelecom sqaron se procesi i portimit të këtij subjekti ka filluar më datë 8.8.2018, dhe prej më shumë se 15 ditësh vullneti i pajtimtarit për portimin e numrit, edhe pas ndërhyrjes së Autoritetit Rregullator, ende nuk është realizuar.
  - Në përfundim Altelecom sh.a., i është drejtuar AKEP, duke i kërkuar marrjen e masave në mënyrë të menjëhershme ndaj Telekom Albania sh.a, për moszbatimin e Rregullores nr. 43, dhe detyrimin e Telekom Albania sh.a., për zbatimin e detyrimit ligjor të realizimit të procesit të portimit të numrave të subjektit Bufalo sh.p.k..
3. Telekom Albania sh.a. në komunikimet me Altelecom dhe AKEP për këtë kërkesë për portim, ka sqaruar se e ka refuzuar portimin e numrave të Bufalo sh.p.k., duke arsyetuar se pajtimtari ka detyrime të pashlyera ndaj kompanisë, duke iu referuar Kontratës me pajtimtarin No. S.34365, datë 15.7.2016 (referenca e Telekom Albania), dhe specifikisht Aneksit nr. 3.1 të kësaj kontrate, që ka të përfshirë edhe shërbimin me brez të gjerë “Broadband”. Ky aneks kontratë me afat 24 muaj, është nënshkruar me datë 15.7.2016, dhe është bërë pjesë e Kontratës me Pajtimtarin “Për dhënien e shërbimeve të telefonisë publike të lëvizshme”. Qëllimi i këtij aneksi është ofrimi i shërbimit me brez të gjerë/broadband për pajtimtarin Bufalo sh.p.k. Shërbimet e Broadband mund të ofrohen përmes tre teknologjive të ndryshme si ADSL, fibrave kabllorë dhe satelitit. Sipas shkresës së Telekom Albania me 6687/1 Prot, datë 31.10.2016, rezulton se shërbimi i aksesit broadband i është ndërprerë pajtimtarit nga sipërmarrësi Telekom Albania sh.a. që prej datës 31.10.2016, për arsye se, subjekti ka kërkuar portim të numrave që më datë 25.10.2016.
4. Bazuar në Rregulloren nr. 43, datë 22.9.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” e ndryshuar, palët, pas përpjekjeve mes tyre përmes mesazheve standarde elektronike për të realizuar procesin e portimit të numrave të Bufalo sh.p.k., kanë vënë në dijeni personin e kontaktit të AKEP lidhur me situatën. Struktura përgjegjëse e AKEP për portabilitetin dhe mbrojtjen e përdoruesit bazuar në komunikimet e palëve, dhe përcaktimet e kontratës së Telekom Albania me pajtimtarin të dërguar gjatë shkëmbimit të korrespondencave me email, më datë 17.08.2018 ka orientuar sipërmarrësin Telekom Albania sh.a. për vijim të procesit të portimit sipas kërkesës së pajtimtarit. Në këtë komunikim struktura e AKEP ka sqaruar palët ndër të tjera se përcaktimet/detyrimet për shërbimin e aksesit broadband sipas aneksit 3.1 të kontratës së lidhur midis TA dhe Bufalo sh.p.k nuk mund të bëhen pengesë për portimin e numrave telefonike celulare sipas kontratës bazë (që i ka kaluar dhe afati minimal 24 muajor në kohën e kërkesës për portim më 8.08.2018). Njëkohësisht, është vënë re se, Telekom Albania ka vijuar normalisht me ofrimin e shërbimeve të telefonisë për numrat objekt i kërkesës për portim edhe pas ndërprerjes së shërbimit broadband më 31.10.2016.

5. Pas sqarimit të AKEP më dstë 17.08.2018, Telekom Albania sh.a. me anë të email të datës 22.8.2018, ka vijuar me qëndrimin e mos pranimit të portimit të numrave për shkak se Bufalo sh.p.k., ka detyrime të pashlyera për shkak të ndërprerjes së kontratës për shërbimet Broadband përpara afatit 24 mujor.
6. Pajtimtari Bufalo sh.p.k. me email të datës 25.8.2018, ka depozituar një ankesë në AKEP. Nëpërmjet kësaj anese, pajtimtari sqaron në lidhje me parregullsinë e kontratës për arsye të firmosjes nga një person i cili nuk ka qenë administrator. Pajtimtari shprehet edhe në lidhje me aneksin e shërbimeve të broadband të cilin pretendon si të parregullt dhe se për këto arsye do vijojë procesin gjyqësor.  
Pas shqyrtimit të kësaj shkrese, u vërejtën mangësi në lidhje me kërkesat mbi kushtet dhe formën, (*lidhur me përcaktimin e saktë të kërkesës nga pajtimtari*) të parashikuara nga Rregullorja nr. 29, datë 29.5.2013 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pajtimtar – sipërmarrës”, dhe pajtimtarit i është kthyer përgjigje për plotësimin e saj sipas kërkesave të Rregullores.
7. Sipas shpjegimeve dhe argumenteve të palëve të përshkruar dhe më sipër, AKEP vlerëson se është e nevojshme që në përputhje me përcaktimet e nenit 22, pika 5, e Rregullores nr. 43, datë 22.9.2016 “Për zbatimin e portabilitetit të numrit” e ndryshuar, të veprojë kryesisht duke nisur një procedim administrativ për të verifikuar e hetuar të gjitha faktet dhe për të vlerësuar të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes dhe marrë një vendim final në lidhje me realizimin e kërkesës për portim të numrave të subjektit Bufalo sh.p.k.

AKEP, gjatë procedurës së hetimit administrativ, do të marrë në konsideratë argumentat e paraqitura nga palët, por gjithashtu do të vijojë me shqyrtimin e mëtejshëm të të gjithë aspekteve të kushteve të kontratës së nënshkruar me pajtimtarin, si edhe për përmbushjen e detyrimeve konform parashikimeve të Rregullores nr. 43, datë 22.9.2016 “Për zbatimin e portabilitetit të numrit” e ndryshuar,

AKEP do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative, për të arritur në një vendimmarrje që do të garantojë interesat legjitime të pajtimtarit si dhe të palëve të përfshira në këtë procedurë administrative.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Në mbështetje të neneve 87 e 88, pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 41 e në vijim, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

### **V E N D O S:**

1. Të fillojë procedimin administrativ për shqyrtimin e kërkesës në lidhje me portimin e numrave të subjektit / pajtimtarit Bufalo sh.p.k.
2. Të njoftohen palët e interesuara për këtë vendim: Bufalo sh.p.k, Telekom Albania sh.a. dhe Altelecom sh.a..
3. Palët të depozitojnë pretendimet/shpjegimet e tyre me shkrim në AKEP brenda datës 30.09.2018.

4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Ilir ZELA**

**ANËTARË:**

- 1. Z.Alban KARAPICI**
- 2. Znj.Edlira DVORANI**
- 3. Znj.Ketrin TOPÇIU**
- 4. Znj.Klarina ALLUSHI**